

**SHPLLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

N r.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	<b>“Specialist Jurist”</b>	Reparti Ushtarak nr.4001, në Tiranë	Tiranë	Pa afat	Po	Po	07.05.2026	20.05.2026

Formulari nr. 1

<b>1.Pozicioni i punës: “Specialist jurist”, në Zyrën Ligjore dhe Prokurimeve.</b>
<b>2. Kodi i pozicionit: N/A</b>
<b>3. Reparti/Institucioni: Reparti Ushtarak nr.4001, në Komandën Mbështetëse, në Tiranë.</b>
<b>4. Vendi: Tiranë</b>
<b>5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar.</b>
<b>6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat</b>
<b>7. Data e fillimit të aplikimit: 07.05.2026</b>
<b>8. Data e mbylljes së aplikimit: 20.05.2026</b>
<p><b>9. Mënyra e aplikimit:</b></p> <p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a>. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në:</p> <p><i>Drejtorinë e Burimeve Njerëzore</i></p> <p><i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i></p> <p><i>Tiranë</i></p>

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
  - formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al). (linku: <https://www.mod.gov.al/index.php/ministria/bazaligjore/integriteti-i-personave-ge-ushtrojne-funksione-publike>)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: **“Specialist Jurist”**
- b. Arsimi : Të ketë përfunduar arsimin e lartë universitar në fushën e shkencave Juridike.
- c. Kualifikimi: Të ketë kualifikime “Master Shkencor/ Profesional” në fushën e Drejtësisë.
- d. Trajnimi: Të ndryshme ose kurse në fushën e prokurimeve.
- e. Eksperienca në Punë: Eksperiencë pune në profesion jo më pak se 5 vite.
- f. Gjuha e huaj: Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.
- g. Kërkesa të tjera specifike: Aftësi shumë të mira të punës në grup dhe të përdor programeve kryesore të kompjuterit, Word, Excel, Power Point.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Sipas VKM nr.731 datë 27.11.2024 “Për miratimin e

rregullores për sigurinë e personelit”.

**Përshkrimi i punës:** Përgjigjet për mmenaxhimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me procedurat ligjore dhe prokurimit ne Komandën Mbështetëse dhe ndihmon Shefin e Degës Ligjore dhe Prokurimit në realizimin e detyrave.

**Detyrat kryesore:**

- Punon për hartimin e të gjitha praktikave ligjore dhe prokurimeve sipas fondeve të vëna në dispozicion dhe hartimin e regjistrit të prokurimeve.
- Vendos ne dispozicion të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dokumentacionin e hartuar për çdo procedurë prokurimi dhe ankandi për shqyrtim duke qenë i pranishëm për çdo procedurë prokurimi dhe ankandi nga fillimi dhe deri në përfundimin e plotë të saj, përfshirë ndërhyrjen me argumentet ligjore dhe nënligjore kur konstatohen shkelje ose moskuptime ose keq interpretime etj..
- Raporton tek Shefi i zyrës dhe kur është e nevojshme te Titullari i Autoritetit Kontraktor herë pas here për ecurinë e punës para. Gjatë zhvillimit dhe pas mbarimit te çdo procedure dhe përgjigjet për zbatimin e detyrave që lindin ngarkohen në përputhje me ligjin për prokurimin publik.
- Merr pjese në hartimin dhe dërgimin në regjistrin e prokurimit në të cilin përfshihet edhe për vitin buxhetor në MM dhe APP sipas afateve.
- Koordino punën për zbatimin e praktikave ligjore, si dhe praktikave për prokurimet dhe ankandet që lidhen me nevojat e Forcave të Armatosura dhe ato të autorizuar nga Ministri i Mbrojtjes.
- Dërgon në afat dokumentacionin për njoftim në APP ose hedhjen në sistemin elektronik..

**13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kerkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.